



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.244/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Nenad Lazić dhe Afjete Sada-Gillogjani anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Demokracisë Plus, me seli në Prishtinë, paraqitur ndaj **Koalicioni PDK-AAK-NISMA**, me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa **Anr.244/2017** e datës 11.06.2017, me të cilin është pretenduar se kandidati për deputet **Ferat Shala**, nga **Koalicioni PDK-AAK-NISMA**, ka vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore në Facebook, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, Demokracisë Plus, me seli në Prishtinë, me datën 11.06.2017, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se me datë 11.06.2017, gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, kandidati për deputet **Ferat Shala**, nga **Koalicioni PDK-AAK-NISMA**, ka vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore në Facebook, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Më këtë rast pretendohet se është bërë thyerje e heshtjes zgjedhore, të përcaktuar me LZP. Me propozim për PZAP-in, që ankesa të miratohet si e bazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, për te provuar se shkelësi i supozuar e ka vazhduar sponsorimin e fushatës edhe në ditën e heshtjes zgjedhore me datë 11.06.2017. Nga prova e ofruar nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se reklama e shkelësit

të supozuar është publikuar në ditën e heshtjes zgjedhore sepse data dhe ora e paraqitur ne fotografi, në shiritin e statusit të pajisjes (fusha e notifikimeve) nuk e dëshmon faktin se e njëjta është publikuar në ditën e heshtjes zgjedhore me datë 11.06.2017, ngase nga fotografia që është paraqitur reklama nuk ekziston data dhe ora e reklamimit-publikimit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.244/2017 më datën 12.06.2017

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.*



Kryesuesi i Panelit

Faton Ademi